



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 101

Datë 2 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 54/2014 datë 29.5.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.....	3927
Ligj nr. 57/2014 datë 5.6.2014	Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar...	3932
Ligj nr. 58/2014 datë 12.6.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.....	3935
Vendim i Kuvendit nr. 43/2014 datë 26.6.2014	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 1, datë 23.1.2014, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr. 24/2014.....	3936
Vendim i Kuvendit nr. 44/2014 datë 26.6.2014	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 58/2013, “Për ngritjen e nënkomisionit “Për të drejtat e njeriut” në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.....	3936
Vendim i Kuvendit nr. 45/2014 datë 26.6.2014	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 33/2014, “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, të ndryshuar.....	3936
Rezolutë e Kuvendit datë 26.6.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013.....	3937
Rezolutë e Kuvendit datë 26.6.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2013.....	3938

LIGJ
Nr. 54/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
LIGJIN NR. 9572, DATË 3.7.2006, "PËR
AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Autoriteti është person juridik, publik, me qendër në Tiranë. Autoriteti është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohet ndërhyrja në veprimtarinë e tij, e cila mund të cenojë pavarësinë e Autoritetit."

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Autoriteti ka të drejtë të nxjerrë akte, që janë rregulloret, rregullat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë e miratuara nga Bordi i Autoritetit, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit."

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Bordi i Autoritetit

Organi vendimmarrës i Autoritetit është Bordi, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët, një kryetar, një drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, një nëndrejtor ekzekutiv dhe dy anëtarë të tjerë."

Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Të ketë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare në një nga këto fusha: ekonomi, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve."

2. Në paragrafin e parë, të pikës 3, fjalët "me përvojë të paktën 3-vjeçare" zëvendësohen me fjalët

"me përvojë profesionale të paktën 7- vjeçare, nga e cila, të paktën, 5 vjet".

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. Në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave."

4. Pas pikës 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Autoritetit persona, të cilët:

a) në tre vitet e fundit kanë qenë ortakë, aksionarë, apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;

b) kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën "a" të këtij paragrafi;

c) në tre vitet e fundit kanë qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura."

5. Paragrafi i parë pas pikës 7 ndryshohet si më poshtë:

"Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtori ekzekutiv i Autoritetit nuk mund të ushtrojnë veprimtari tjetër me pagesë, me përjashtim të mësimdhënies, veprimtarive kërkimore shkencore, apo pjesëmarrjes në organizata vendase apo ndërkombëtare, që kanë lidhje me veprimtarinë e Autoritetit."

6. Në paragrafin e dytë, pas pikës 7, në fjalinë e parë, fjalët: "Katër anëtarët e tjerë", zëvendësohen me fjalët "Kryetari dhe dy anëtarët e tjerë".

Neni 4

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6

Emërimi i anëtarëve të Bordit

Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi.

Kryetari emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, pas një procedure përzgjedhëse.

Anëtari i Bordit, që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, pas një procedure përzgjedhëse.

Anëtari i Bordit, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Ministrisë të Financave, pas një procedure përzgjedhëse.

Dy anëtarët e tjerë emërohen nga Kuvendi, me propozimin, përkatësisht, nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pas një procedure përzgjedhëse.

Kandidati i propozuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nuk mund të jetë anëtar i këtij Këshilli."

Neni 5

Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Mandati i çdo anëtari të Bordit është 5 vjet. Në rastet kur mandati i anëtarit ka përfunduar, secili prej tyre qëndron në detyrë deri në çastin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, por jo më shumë se tre muaj. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Bordit, Autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikat për zgjedhjen e anëtarit të ri.”.

2. Në paragrafin e dytë, fjalia e dytë shfuqizohet.

3. Në paragrafin e tretë, fjalët “për një periudhë dyvjeçare” zëvendësohen me fjalët “për një periudhë trevjeçare”.

4. Paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Personi që ka qenë i emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv dhe i ka mbaruar mandati, pas largimit nga detyra, kur nuk është i punësuar, përfiton një vit nga e drejta për shpërblim në vlerën e pagës që ka pasur, kur ka qenë në detyrë. Në rast punësimi, kur paga që marrin është më e vogël se ajo e parashikuar në këtë paragraf, ata kompensohen deri në, por në asnjë rast mbi, nivelin e pagës së muajit të fundit të përfutur gjatë detyrës, brenda një viti nga dorëzimi i detyrës. Pagesat e kryera në favor të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv, sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, përballohen nga Autoriteti dhe parashikohen si pjesë e buxhetit të Autoritetit. Nga kjo e drejtë nuk përfiton individ i riemëruar anëtar i Bordit, si dhe ai që është liruar nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 8.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Struktura organizative, pagat dhe trajtimet e tjera të Autoritetit

Bordi përcakton strukturën organizative të Autoritetit, numrin e punonjësve, pagën, shpërblimet dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve. Trajtimet financiare përfshijnë mbulimin e shpenzimeve të kryera në përmbushje të detyrës, pagesat për trajnimet profesionale, për sigurimin e jetës dhe të shëndetit dhe të tjera të ngjashme. Bordi, në përcaktimin e masës së pagës, shpërblimeve dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të administratës, bazohet në një metodologji të qartë, që merr parasysh kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitetin e rregullatorit financiar në Shqipëri dhe nevojat e vetë institucionit.

Autoriteti, mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punëmarrësit e tij.

Përcaktimet e bëra në dispozitat e ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, dhe çdo përcaktim tjetër ligjor, si edhe përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e këtyre dispozitave, që bien në kundërshtim me këtë nen, nuk zbatohen për Autoritetin.”.

Neni 7

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Mbledhjet e Bordit drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtari joekzekutiv më i vjetër në moshë.”.

2. Në paragrafin e tretë dhe të katërt, fjalët “4 anëtarë” zëvendësohen me fjalët “3 anëtarë”.

3. Paragrafi i gjashtë ndryshohet si më poshtë:

“Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e marra në mbledhje nënshkruhen nga Kryetari dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.”.

Neni 8

Në nenin 13, pika 1, dhe pika 2, shkronja “c”, si dhe në nenin 32, paragrafi i parë, fjalët “akt nënligjor” zëvendësohen me fjalët “akt i Autoritetit”.

Neni 9

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Kompetencat e Bordit

Bordi ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:

1. Miraton politikat e licencimit, të rregullimit dhe të mbikëqyrjes, për të nxitur zhvillimin e tregjeve financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi.

2. Miraton rregullat, rregulloret, vendimet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe udhëzues për interpretimin dhe zbatimin e ligjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji e të legjisllacionit në fuqi.

3. Miraton të gjitha raportet që dërgon Autoriteti në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

4. Miraton, refuzon, pezullon apo heq licencat ose autorizimet për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve në tregjet financiare që mbikëqyren, si dhe rregullat përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi.

5. Miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese për subjektet e mbikëqyrura.

6. Miraton standarde kontabël dhe format e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet e mbikëqyrura.

7. Miraton kodin e etikës, rregulloren e funksionimit të Bordit dhe rregulloret për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit, që nxirren në zbatim të këtij ligji.

8. Miraton strategjitë, politikat dhe rregulloret e administrimit të përgjithshëm të Autoritetit, politikën e investimit në depozitat bankare apo në titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë së Autoritetit.

9. Miraton rregulloren për krijimin, investimin dhe përdorimin e fondit të rezervës së Autoritetit.

10. Miraton strukturën organizative të Autoritetit dhe numrin e punonjësve si dhe përshkrimet e punës dhe ndarjet funksionale.

11. Miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve.

12. Miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit.

13. Miraton rregullat për përcaktimin e elementeve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

14. Miraton buxhetin e Autoritetit, llojet e shpenzimeve, si dhe alokimet e përdorimit e fondit të rezervës.

15. Miraton pasqyrat financiare të Autoritetit.

16. Emëron drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese të Autoritetit.

17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.

18. Miraton nënshkrimin e memorandumëve të mirëkuptimit, të marrëveshjeve të shkëmbimit të informacionit me autoritete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

19. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për vitin e mëparshëm, i cili paraqitet në Kuvend në muajin prill të çdo viti, së bashku me pasqyrat financiare të audituara.

20. Miraton raportin e mbikëqyrjes, ku paraqitet gjendja dhe perspektiva e tregjeve që mbikëqyren, i cili botohet në muajin korrik të çdo viti.

21. Vendos për masat e mbikëqyrjes dhe sanksionet ndaj subjekteve të mbikëqyrura.

22. Ushtron çdo kompetencë tjetër dhënë Autoritetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi.

Vendimet e marra janë objekt ankimi në gjykatë.

Vendimet e Bordit arsyetohen dhe publikohen në mënyrën e caktuar prej tij për publikimin e njoftimeve zyrtare.

Vendimet e Bordit me karakter individual i njoftohen menjëherë subjekteve të interesuara.”.

Neni 10

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Kompetencat e Kryetarit të Bordit

Kryetari i Bordit ka këto kompetenca:

1. Thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit.
2. Paraqet rendin e ditës.
3. Urdhëron ngritjen e komiteteve të kontrollit, objektin e punës, si dhe afatet për shqyrtimin e çështjes.
4. I propozon Bordit ngritjen e komiteteve këshillimore, me qëllim hartimin e politikave për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit.
5. Kompetenca të tjera, të akorduara me vendimmarrje të Bordit.”.

Neni 11

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:

1. Përfaqëson Autoritetin.
2. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.
3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.
4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij.
5. Nxjerr urdhra dhe udhëzime në përmbushje të kompetencave të tij me karakter ekzekutiv.
6. Emëron dhe shkarkon punonjësit e Autoritetit.
7. Shkëmben të dhëna me Bankën e Shqipërisë, me institucione e agjenci të tjera qeveritare, me autoritete dhe administrata vendore, me organizata jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari të lidhura me tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe me subjektet e mbikëqyrura.
8. Bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë për inspektimin në bankat depozitare të veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti.

9. Kërkon nga Banka e Shqipërisë kryerjen e inspektimeve me objekt të caktuar në banka, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vënien në dispozicion të rezultateve të inspektimit.

10. Përmbush detyra dhe përgjegjësi të tjera, në përputhje me rregulloret e brendshme të Autoritetit.

Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij.”.

Neni 12

Në nenin 17, paragrafi i parë, në fjalinë e parë, fjalët “Katër anëtarët e Bordit, të cilët nuk kryejnë funksione drejtuese” zëvendësohen me fjalët “Tre anëtarët e Bordit, të cilët nuk kryejnë funksione ekzekutive”.

Neni 13

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Kudo ku referohet për kompetencë të “Kryetarit të Bordit”, ndryshohet si kompetencë e “Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv”.

2. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarët e Bordit të Autoritetit dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij nuk mund të jenë individualisht përgjegjës për dëmin që mund t’u shkaktohet personave të mbikëqyrur nga veprimet apo mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur veprimet apo mosveprimet janë kryer me faj dhe në mënyrë të qëllimshme. Autoriteti dëmshpërblen anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij për kostot ligjore të lindura gjatë procesit të mbrojtjes prej veprimeve ligjore të ndërmarra kundër tyre, për shkak të ushtrimit të funksioneve apo të detyrave të tyre, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit në fuqi.”.

Neni 14

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Autoriteti lidh marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar, agjenci apo institucione të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose institucione të tjera të njohura me ligj, për të bashkëpunuar, shkëmbyer informacione, apo kryer inspektime të përbashkëta.

2. Autoriteti kryen hetime, në emër dhe për llogari të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse vendase apo të huaja, në sektorin financiar të agjencive apo institucioneve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose institucioneve të tjera të njohura me ligj, me kërkesë të tyre.

3. Autoriteti shkëmben me autoritetet dhe institucionet vendase apo të huaja, sipas fushave përkatëse të veprimtarisë:

a) informacion për subjektet e mbikëqyrura;

b) informacion për lëshimin e licencave;

c) informacion që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ç) informacion që lidhet me mashtrimin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushat e mbikëqyrura;

d) të dhëna të natyrës financiare;

dh) informacion për personat fizikë, të cilët mbajnë poste me përgjegjësi në këto subjekte.

4. Çdo informacion që merr Autoriteti dhe çdo informacion që i jepet një autoriteti tjetër mbikëqyrës trajtohet si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime të përcaktuara në ligj apo në akte nënligjore.

5. Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rreth fakteve dhe rrethanave që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij mbikëqyrëse dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.”.

Neni 15

Në nenin 19, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Inspektimi ushtrohet nga nëpunësit e Autoritetit, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, ose, në mungesë dhe me autorizimin e lëshuar prej tij, nga nëndrejtori ekzekutiv. Inspektimi bëhet me ose pa paralajmërim.”.

Neni 16

Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të paragrafit të parë, fjala “kryetarit” zëvendësohet me fjalët “Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv”.

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Autoritetit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji, si dhe të akteve të Autoritetit.”.

Neni 17

Neni 21 shfuqizohet.

Neni 18

Në nenin 23, në fund të paragrafit të parë, fjala “Kryetarit” zëvendësohet me fjalët “Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv”.

Neni 19

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Financimi dhe buxheti

Autoriteti është institucion financiarisht i pavarur dhe financohet me burime të veta.

Të ardhurat e Autoritetit krijohen nga:

a) tarifavat e mbledhura, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;

b) gjobat e vendosura, në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe penalitetet e vendosura për pagesat e vonuara të tarifave, të përcaktuara në nenin 27 të këtij ligji;

c) dhënia me qira e ambienteve në pronësi të Autoritetit;

ç) investimi në depozita bankare apo titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

d) burime dhe veprimtari të tjera të lejuara nga ky ligj ose legjislacioni në fuqi.

Të ardhurat e Autoritetit përdoren:

a) për të mbuluar shpenzimet që kryen Autoriteti në përmbushje të përgjegjësive të tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

b) për të kryer investime apo zbatuar projekte në përmbushje të përgjegjësive të tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

c) për të krijuar dhe mbajtur fondin e rezervës. Me “fond rezervë”, për qëllime të këtij ligji, kuptohet fondi, në të cilin alokohet diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor dhe që shërben për të mbuluar diferencën negative ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor. Alokimi i të ardhurave në fondin e rezervës kryhet derisa ky fond të arrijë nivelin mesatar gjatshëmujor të buxhetit të Autoritetit për tre vitet e fundit.”.

Neni 20

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Përcaktimi i tarifave për subjektet e mbikëqyrura

Autoriteti mbledh nga subjektet e mbikëqyrura:

1. Tarifa për aplikim, dhënie e rinovime licencash, miratimesh dhe autorizimesh, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të legjislacionit në fuqi apo rregulloreve të Autoritetit.

2. Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura, të licencuara nga Autoriteti.

3. Tarifa për projekte të veçanta, prej të cilave përfitojnë subjektet e mbikëqyrura. Të ardhurat nga këto tarifa përdoren vetëm për financimin dhe mirëmbajtjen e këtyre projekteve.

Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura caktohet në nivelin deri në 1,5 për qind të:

a) volumit të primeve të shkruara bruto vjetore nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jojetës;

b) volumit të primeve të shkruara, pasi janë zbritur elementet e kursimit, vjetore, nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jetës;

c) vlerës së përgjithshme të aseteve të fondit të pensioneve vullnetare dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

ç) volumit të përgjithshëm të transaksioneve vjetore të realizuara në bursë apo në një treg të rregulluar;

d) treguesit të përzgjedhur si bazë në këtë ligj, në legjislacionin në fuqi apo në rregulloret e Autoritetit për subjektet e tjera të mbikëqyrura, që nuk përcaktohen në shkronjat “a” deri në “ç” të këtij paragrafi.

Rakordimi përfundimtar i shumës së tarifës së mbikëqyrjes për t’u paguar kryhet brenda një muaji nga paraqitja në Autoritet e pasqyrave financiare të audituara të subjektit të mbikëqyrur ose nga paraqitja e pasqyrave financiare vjetore përfundimtare, për ato subjekte që nuk kanë detyrim auditimi ligjor.

Tarifat e paguara nga subjekti i mbikëqyrur llogariten si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Kur fondi i rezervës është në nivelin e përcaktuar në shkronjën “c”, të nenit 26, të këtij ligji, çdo tepicë që mbetet nga të ardhurat vjetore të Autoritetit njihet dhe regjistrohet si paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për periudhën pasardhëse, duke e shpërndarë në mënyrë përpjesëtimore me kontributin e tyre.”.

Neni 21

Në nenin 29, në paragrafin e fundit, fjalët “Kryetari i Bordit” zëvendësohen me “Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv”.

Neni 22

Në nenin 31, fjalia e parë, e paragrafit të fundit, ndryshohet si më poshtë:

“Njoftimi për vendimin e marrë nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.”.

Neni 23

Kudo në këtë ligj fjalët “pension suplementar” zëvendësohen me fjalët “pension vullnetar”, ndërsa fjalët “tregje financiare jobankare” zëvendësohen me fjalët “tregje financiare që mbikëqyren”.

Neni 24
Dispozitë kalimtare

Kryetari i Bordit, nënkryetaret dhe anëtarët e tjerë, të zgjedhur në këtë funksion para hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e Bordit të ri.

Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi miraton anëtarët e rinj të Bordit.

Brenda një muaji nga konfigurimi i Bordit të ri, miratohet struktura e re organizative dhe rregulloret e përshkrimit të punës dhe ndarjes së funksioneve.

Anëtarët e rinj të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të emëruar në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kanë si rast përjashtimor, vetëm për mandatin e parë, këto afate emërimi:

- a) Kryetari, 4 vjet;
- b) Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, 5 vjet;
- c) nëndrejtori ekzekutiv, 4 vjet;
- ç) anëtarët e tjerë, 3 vjet.

Neni 25

Ky ligj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 29.5.2014

**LIGJ
Nr. 57/2014**

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT EKONOMIK KOMBËTAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

1. Krijimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar (KEK), për garantimin e bashkëpunimit institucional dhe të partneritetit publik-privat për zhvillimin e politikave ekonomike, për garantimin e dialogut dhe këshillimit ndërmjet organeve të administratës shtetërore dhe sektorit privat, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat në këtë proces.

2. Përcaktimin e parimeve dhe procedurave, në bazë të të cilave bazohet dhe zhvillohet procesi i dialogut dhe i këshillimit në KEK.

Neni 2
Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji janë nismat dhe praktikat e organeve të administratës shtetërore për ndryshimin e ligjeve apo akteve nënligjore, si dhe projektet për ndryshimin e politikave, të cilat kanë ndikim në fushat e ekonomisë, konkretisht:

a) strategjitë dhe programet qeveritare të zhvillimit të ekonomisë;

b) përgatitja e Buxhetit të Shtetit dhe paketave fiskale;

c) politikat e privatizimit dhe prokurimeve publike;

ç) politikat e nxitjes së investimeve;

d) politikat e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;

dh) politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve;

e) politikat e punësimit dhe të pagave;

ë) politikat e edukimit dhe zhvillimit të kërkimit shkencor;

f) monitorimi i ndikimit në klimën e biznesit i praktikave rënduese burokratike dhe rastet e arbitraritetit të administratës shtetërore;

g) përmirësimi i legjislacionit tatimor dhe procedurave përkatëse;

gj) çështje të tjera me ndikim në zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Shqipërisë.

2. Me nisma të organeve të administratës shtetërore nënkuptohen të gjitha projektet për ndryshimin e ligjeve apo akteve nënligjore, si dhe projektet për ndryshimin e politikave me ndikim në fushat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 3

Parimet në të cilat mbështetet procesi i këshillimit publik

1. Procesi i këshillimit publik në KEK bazohet në:

a) parimin e publikimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të grupeve të interesit të propozimeve e projektakteve dhe/ose politikave që propozohen nga administrata shtetërore;

b) parimin e këshillimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve e sugjerimeve me biznesin, mbi të cilin kanë ndikim nismat legjislative dhe/ose politikat e reja të propozuara nga administrata shtetërore;

c) parimin e angazhimit të grupeve të interesit, nëpërmjet përfshirjes së grupeve të ndryshme të interesit në procesin e identifikimit dhe formulimit të çështjeve, politikave dhe zgjidhjeve, objekt i rregullimit.

2. Dialogu në KEK zhvillohet nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, vërejtjeve, sugjerimeve e propozimeve përmes faqes zyrtare të internetit të këtij këshilli, mbledhjes periodike të përfaqësimit të lartë dhe takimeve e formave të tjera të organizimit në funksion të realizimit të qëllimeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Neni 4

Publikimi i nismave ligjore

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë përzgjedh nga nismat e organeve të administratës shtetërore ato nisma që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, siç përcaktohet në nenin 2, të cilat ia paraqet, sipas parashikimit të pikës 2, të këtij neni, sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, i krijuar në përputhje me përcaktimin e nenit 9 të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për ekonominë merr në dorëzim nga organet e administratës shtetërore dhe vë në dispozicion të sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, pa pagesë, sa më poshtë:

a) informacion në lidhje me qëllimin e nismës ku shpjegohet se:

i) çfarë synohet të rregullohet, të ndryshohet dhe/ose të përmirësohet;

ii) cili është ndikimi në sektorin privat;

iii) cili është ndikimi financiar i parashikuar;

iv) informacione të tjera që janë të nevojshme për të shpjeguar nismën në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme;

b) tekstin e ligjit dhe/ose aktit nënligjor që propozohet;

c) kur është rasti, tekstin e ligjit dhe/ose aktit nënligjor ekzistues ku janë integruar ndryshimet e propozuara;

ç) tekstin e politikës që propozohet;

d) kur është rasti, tekstin e politikës ekzistuese ku janë integruar ndryshimet e propozuara.

3. Sekretariati teknik publikon në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar informacionin e marrë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 5

Faqja zyrtare e internetit dhe marrja e mendimit

1. Grupet e interesit, të cilat ndikohen nga nismat legislative të organeve shtetërore, mund të paraqesin vërejtjet, komentet a sugjerimet drejtpërsëdrejti në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar. Gjithashtu, grupet e interesit mund të kërkojnë nga sekretariati teknik i këtij Këshilli që të publikojë në faqen e vet zyrtare të internetit edhe ato nisma të organeve të administratës shtetërore, të cilat nuk janë përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për ekonominë, sipas nenit 4, të këtij ligji, por që grupet e interesit i konsiderojnë të përfshira në fushën e zbatimit të këtij ligji, siç përcaktohet në nenin 2 të këtij ligji.

2. Afati, brenda të cilit grupet e interesit duhet të paraqesin vërejtjet, komentet e sugjerimet e tyre, është 60 ditë kalendrike nga e nesërmja e publikimit të projektaktit të parashikuar në nenin 4 të këtij ligji. Po kështu, për 60 ditë kalendrike nga e nesërmja e publikimit, organet shtetërore angazhohen të mos i japin fuqi ligjore projektaktit të përgatitur prej tyre.

3. Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar grumbullon vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e përmendura në këtë nen, të cilat i përpunon e ia transmeton organit shtetëror që ka marrë nismën për përgatitjen e aktit.

4. Përfundimisht, në rastet e nevojës për përshejtimin e procesit të miratimit të projektakteve, sekretariati teknik, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, vendos që të mos kryhet procesi i konsultimit, sipas këtij neni, ose që afatet e sipërpërmendura të shkurtohen. Në çdo rast, në momentin e publikimit të projektakteve në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, sekretariati teknik publikon edhe afatin për dhënien e komenteve.

5. Kushtet dhe rregullat për përcaktimin e subjekteve, të cilave do t'u jepet akses në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar për të publikuar aty sugjerimet dhe komentet e tyre, përcaktohen nga sekretariati teknik.

Neni 6

Angazhimi i grupeve të interesit

1. Grupet e interesit, përveç sa përcaktohet më sipër në këtë ligj, mund të parashtrajnë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar propozimet e tyre për legjislacion të ri apo për takime e forma të tjera organizimi, sipas nenit 8 të këtij ligji.

2. Në rastet kur grupet e interesit propozojnë ndryshime në ligjet, aktet nënligjore dhe/ose politikat ekzistuese apo aktet nënligjore dhe/ose politikat e reja, propozimet e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a" - "d", të pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji.

3. Grupet e interesit mund të denoncojnë nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar çdo praktikë burokratike të tepërt, veprim arbitrar, moszbatim të ligjit apo abuzim me ligjin dhe autoritetin shtetëror nga ana e administratës shtetërore ndaj subjekteve private.

4. Grupet e interesit, që kanë të drejtën e veprimeve në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, sipas këtij neni dhe nenit 5, të këtij ligji, konsiderohen vetëm organizatat e biznesit të krijuara, të regjistruara dhe që zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin.

Neni 7

Përbërja dhe takimi periodik i nivelit të lartë

1. KEK organizon takime periodike duke u mbledhur çdo muaj në ambientet e ndërtesës së Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Takimet drejtohen nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, i cili është Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar. Ministri përgjegjës për ekonominë është zëvendëskryetar dhe

kryen detyra në zbatim të këtij ligji dhe ato të deleguara nga Kryetari i Këshillit.

2. Në këto takime marrin pjesë:

- a) Kryeministri;
- b) ministri përgjegjës për ekonominë;
- c) ministri përgjegjës për financën;
- ç) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
- d) jo më shumë se 6 personalitete të ekonomisë kombëtare dhe botërore;
- dh) jo më shumë se 6 nga tatimpaguesit më të mëdhenj të biznesit privat, vendas ose të huaj, të përfaqësuar nga përfaqësuesit e tyre ligjorë;
- e) jo më shumë se 4 organizata biznesi, të krijuara, të regjistruara dhe që zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin, të përfaqësuar nga përfaqësuesit e tyre ligjorë;
- ë) Sekretari i Përgjithshëm.

3. Përveç subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, në këto takime marrin pjesë si të ftuar të përhershëm edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në Fondin Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund – FMN), Korporatën Financiare Ndërkombëtare (International Financial Corporation – IFC), Bankën Botërore (World Bank – WB), Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (European Bank for Reconstruction and Development – EBRD), si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve e Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

4. Me miratimin e Kryetarit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, ftohen të marrin pjesë në këto takime, rast pas rasti, edhe personat e mëposhtëm:

- a) ministri i linjës ose përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore që mbulojnë fushën, problematika e së cilës diskutohet në një mbledhje të caktuar;
- b) akademikë, vendas dhe/ose të huaj, të shquar në fushën e ekonomisë, apo personalitete të tjera;
- c) përfaqësues të organizatave të tjera të biznesit;
- ç) subjekte të tjera.

5. Subjektet e përcaktuara në shkronjat “d” dhe “e”, të pikës 2, të këtij neni, përzgjidhen nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar ndërmjet atyre subjekteve që aplikojnë pranë sekretariatit teknik për të marrë pjesë në takimet periodike. Këto subjekte marrin pjesë në takime për një periudhë gjashtëmujore nga dita e pranimit të pjesëmarrjes së tyre dhe me kalimin e kësaj periudhe ata zëvendësohen nga subjekte të tjera, që i përkasin së njëjtës kategori.

6. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij neni, përcaktohen nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në këto takime për një periudhë që do të përcaktohet, sipas rastit, në varësi të mundësisë së tyre.

7. Pjesëmarrja në këto takime e subjekteve të përmendura në shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 2, të këtij neni, mund të ndalohej nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar, nëse ata shkelin detyrimin për të mbajtur konfidencial dhe për të mos përhapur në media, në shtypin e shkruar apo në çdo formë a forum tjetër informacionet që marrin për shkak të pjesëmarrjes së tyre në këto takime. Zëvendësimi i tyre bëhet nga subjektet e tjera në listën e aplikuesve për të marrë pjesë në këto takime.

8. Pjesëmarrja në takimet periodike është pa shpërblim. Subjektet e përmendura në shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 2, të këtij neni, mund të heqin dorë në çdo kohë nga pjesëmarrja në këto takime.

9. Mënyra e organizimit të mbledhjeve përcaktohet sipas rregullores për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, të miratuar nga KEK.

10. Rendi i ditës i takimeve periodike përgatitet nga sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe miratohet nga zëvendëskryetari, pas këshillimit me Kryetarin e Këshillit.

11. Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar u bën të ditur pjesëmarrësve në takim, të paktën 7 ditë kalendrike përpara, kohën kur do të zhvillohet takimi, çështjet për diskutim në rend dite, si dhe u vë në dispozicion materialet e takimit.

Neni 8

Forma të tjera këshillimi të Këshillit Ekonomik Kombëtar

1. Me akt nënligjor të Kryetarit të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë apo të Sekretarit të Përgjithshëm mund të krijohen komisione këshillimi, si struktura ad hoc të këshillit për të mbuluar fusha dhe sektorë specifikë. Komisionet e këshillimit janë të përkohshme dhe përfundojnë funksionimin e tyre me mbarimin e detyrave që u janë ngarkuar. Ato drejtohen nga ministri përgjegjës për ekonominë. Komisionet e këshillimit kryejnë detyrat e përcaktuara në aktin e krijimit të tyre. Me propozimin e tyre dhe me vendim të Këshillit Ekonomik Kombëtar, ato mund të ngrënë sekretariate të këshillimit sektorial.

2. Këshilli Ekonomik Kombëtar mund të organizojë, nëpërmjet sekretariatit teknik të tij, takime midis grupeve të interesit dhe organeve e institucioneve të ndryshme të administratës shtetërore, që do të ndërmerren me kërkesë të grupeve të interesit apo organeve shtetërore.

3. Këshilli Ekonomik Kombëtar mund të organizojë edhe forma të tjera këshillimi, të cilat mund të jenë të përshtatshme sipas rastit.

Neni 9

Sekretariati teknik

1. Pranë Këshillit Ekonomik Kombëtar funksionon sekretariati teknik që kryen funksione ndihmëse dhe administrative, me seli pranë ambienteve të ndërtesës së Kryeministrit. Aktiviteti i tij rregullohet sipas këtij ligji, duke përjashtuar zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

2. Sekretariati teknik kryen funksionet e mëposhtme:

a) administron faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe përcakton rregullat e aksesit në këtë faqe;

b) grumbullon dhe përpunon komentet, vërejtjet, sugjerimet, denoncimet dhe propozimet e grupeve të interesit në procesin e këshillimit publik, të zhvilluar sipas këtij ligji;

c) u dërgon ministrive përkatëse, Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe/ose institucioneve të tjera shtetërore informacionin e përpunuar dhe dokumentacionin shoqërues, kur është rasti;

ç) monitoron dhe zbaton projektet dhe nismat e Këshillit Ekonomik Kombëtar;

d) ndihmon dhe mbështet Këshillin Ekonomik Kombëtar në punën dhe mbarëvajtjen e takimeve;

dh) me kërkesë të Kryetarit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, kryen anketime, përgatit raporte dhe studime për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së këshillit;

e) analizon fenomenet e praktikave arbitrare apo shqetësime të tjera të identifikuara nga organizatat e biznesit dhe jep rekomandimet përkatëse;

ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar.

3. Sekretariati teknik drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ekonomik Kombëtar, i cili e kryen këtë funksion pa shpërblim. Sekretari i Përgjithshëm përfaqëson sekretariatit teknik në marrëdhënie me të tretët.

4. Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar emëron Sekretarin e Përgjithshëm nga radhët e biznesit me eksperiencë në fushën ligjore dhe/ose ekonomike, për një afat katërvjeçar, me të drejtë riemërimi. Sekretari i Përgjithshëm nuk është funksionar publik dhe nuk gëzon statusin e nëpunësit civil. Sekretari i Përgjithshëm drejton dhe mbikëqyr punën e sekretariatit teknik si monitorues dhe mediator i dialogut shtet-privat dhe kryen detyrat e tjera të ngarkuara nga ky ligj.

5. Struktura organizative e sekretariatit teknik miratohet nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së personelit të sekretariatit teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të

Republikës së Shqipërisë dhe punonjësit e këtij sekretariati nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

6. Pagat dhe kontributet për personelin e sekretariatit teknik, si dhe shpenzimet e tjera që lidhen me funksionimin e tij sigurohen nëpërmjet dhurimeve, sponsorizimeve e burimeve të tjera të ligjshme, pa rënë ndesh me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

7. Sekretariati teknik mund të vendosë që të rimbursojë shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen dhe angazhimin, pranë Këshillit Ekonomik Kombëtar, të subjekteve të përmendura në nenin 7, pika 2, shkronja “ç”, dhe pika 4, shkronja “b”, të këtij ligji.

Neni 10

Dispozita të fundit

Ligji nr. 9607, datë 11.9.2006, “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit”, shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.6.2014

Shpallur me dekretin nr. 8614, datë 30.6.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ**Nr. 58/2014**

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9584, DATË 17.7.2006, “PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pika 1, emërtimi “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” shfuqizohet.

Neni 2

Në lidhjen nr. 1, që përmendet në nenin 4, bëhen këto ndryshime:

- a) Në klasifikimin “D”, pika 2 shfuqizohet.
- b) Në klasifikimin “E”, pika 3 shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.6.2014

Shpallur me dekretin nr. 8615, datë 30.6.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**VENDIM
Nr. 43/2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 1, DATË 23.1.2014, “PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PËR REFORMËN ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN
NR. 24/2014**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit dhe pikës V të vendimit të Kuvendit nr. 1/2014, me kërkesën e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 1/2014, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr. 24/2014, bëhet ky ndryshim:

- I. Në pikën V, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
“V. Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm shtyhet deri në datën 31.7.2014.”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 26.6.2014

**VENDIM
Nr. 44/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 58/2013, “PËR NGRITJEN E
NËNKOMISIONIT “PËR TË DREJTAT E
NJERIUT” NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET
LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, dhe 19, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 58/2013, “Për ngritjen e nënkomisionit “Për të drejtat e njeriut” në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, në pikën III bëhen këto ndryshime:

- I. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë.
- II. Deputetja Silva Caka caktohet anëtare në vend të deputetit Luan Duzha.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 26.6.2014

**VENDIM
Nr. 45/2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 33/2014, “PËR PROCEDURËN
PARAPRAKE TË PËRZGJEDHJES SË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe në zbatim të nenit 19, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Në vendimin e Kuvendit nr. 33/2014, “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Komisionerit të Shërbimit Civil”, të ndryshuar, në pikën 1, shkronja “a”, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“a) Nga shërbimet e Kuvendit të bëhet shpallja dhe bërja publike e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik), për një afat prej 45 ditësh nga publikimi.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 26.6.2014

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR
VITIN 2013**

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Rolin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion i pavarur, dhe autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

- Angazhimin publik të Komisionerit për rritjen e sensibilizimit të qytetarëve, në lidhje me të drejtat që i garantohen nga kuadri ligjor shqiptar dhe ai ndërkombëtar, për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Përpjekjet e Komisionerit për rritjen e numrit të inspektimeve dhe riinspektimeve me iniciativë në sektorë të ndryshëm që mbledhin e përpunojnë të dhëna personale.

- Përfshirjen e Komisionerit në procesin e dhënies së mendimeve ligjore për projektakte ligjore e nënligjore, me synim përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Rolin aktiv në trajnimin e kontrolluesve për njohjen e legjislacionit e të dhënave personale.

Konstaton se gjatë vitit 2013:

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka ushtruar një numër të konsiderueshëm kontrollesh dhe inspektimesh me iniciativë. Krahasuar me vitin 2012, ka rritur numrin e kontrolleve dhe hetimeve me iniciativë në kontrollues publik e privat.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka trajtuar 26 ankesa nga qytetarë të ndryshëm, lidhur me cenim të dhënash personale. Megjithëse ka rritje në kalim me vitet e kaluara, ky trend është larg pritshmërive që ky institucion ka në përmbushje të misionit në tij ligjor.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në procesin e njoftim-regjistrimit, ka pasur rënie të regjistrimit të subjekteve kontrolluese, krahasuar me vitin e kaluar.

- Gjatë procesit të monitorimit të zbatueshmërisë së rekomandimeve nuk ka qenë shumë proaktiv në ndjekjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dhënë mendime ligjore për projektakte ligjore e nënligjore, sa herë i është kërkuar, me synim përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar “Manualin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fushën e medias”. Manuali është një standard i marrë nga praktika ndërkombëtare dhe i shtohet numrit të udhëzimeve të miratuara nga Komisioneri në këtë fushë.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pasur një aktivitet të ngjeshur për ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe të publikut, duke zhvilluar trajnime e seminare në sektorë tepër të rëndësishëm, si në atë të policisë, prokurorisë, shëndetësisë, sektorin bankar dhe telekomunikacionit.

Për vitin 2014 kërkon:

1. Rritjen e numrit të inspektimeve dhe riinspektimeve me tematikë, në sektorë të ndryshëm që mbledhin e përpunojnë të dhëna personale.

2. Rol më proaktiv të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në monitorimin e zbatimit të udhëzimeve, rekomandimeve, pas kontrolleve dhe inspektimeve, që ushtron në kontrollues publikë dhe privatë.

3. Angazhim në vazhdimësi për dhënien e opinioneve ligjore nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përgatitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore, që kanë lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

4. Bashkëpunim me AKEP-in, lidhur me monitorimin procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetasve, nga kompanitë mobile, si një detyrim që kompanive u rrjedh nga ligji i AKEP-it.

5. Bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, lidhur me anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore, të cilat aktualisht ndodhen të publikuara në portalet zyrtare të gjykatave.

6. Bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, për monitorimin e procesit të ruajtjes së regjistrave të përgjithshëm të noterisë, si dhe regjistrin të testamenteve, si akte që disponojnë të dhëna personale të shtetasve.

7. Angazhimin maksimal të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në drejtim të një identifikimi sa më të plotë të subjekteve kontrolluese e përpunuese dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e subjekteve kontrolluese.

8. Vazhdimin e promovimit të praktikave më të mira në fushën e të dhënave personale, me qëllim sensibilizimin e opinionit publik lidhur me legjislacionin e të dhënave personale.

9. Angazhim më të madh publik në nxitjen e kontrolluesve për hartimin e kodeve të etikës dhe vlerësimin e tyre, në respekt të nenit 31/gj të ligjit nr. 9887, datë 15.2.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

10. Regjistrimi i çdo ankese pranë një regjistri të posaçëm, për ankesat që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës, si dhe përfshirja e tyre në raport, për efekte studimore dhe informuese, lidhur me shkallën e perceptimit që qytetarët kanë për legjislacionin e të dhënave personale.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 26.6.2014

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
PËR VITIN 2013**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Mbështet rolin kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë, për përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe për veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, ku shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet garantojnë nga shteti;

- Dëshmon vullnetin e tij për të garantuar pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së këtij institucioni, me qëllim përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit të jashtëm;

- Nxiti përmbushjen e misionit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, si dhe në përmirësimin e metodologjisë së kontrollit;

- Vlerëson rëndësinë themelore që ka raportimi vjetor në Kuvend për veprimtarinë e institucionit, në përmbushje të detyrimit kushtetues dhe ligjor, si mjet i ushtrimit të funksionit të kontrollit efektiv parlamentar.

Konstaton se gjatë vitit 2013 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka kryer të gjitha auditimet e planifikuara në drejtim të veprimtarisë kontrolluese. Edhe pse rezultoi rritje e rekomandimeve të dhëna nga KLSH-ja në drejtim të masave organizative, masave disiplinore, kallëzimeve penale, si dhe përmirësimeve ligjore, mbetet problematikë shkalla e ndjekjes së tyre nga ana e

organit rekomandues, me qëllim evidentimin e pritsmërive lidhur me masën e dëmit të shlyer për llogari të Buxhetit të Shtetit.

- Efektshmëria e masave disiplinore dhe administrative të rekomanduara, por dhe shkalla e përmbushjes së tyre nga institucionet përgjegjëse, për vitin 2013 rezultoi në nivel mesatar.

- Në raport mungon analiza në lidhje me fenomenin e rritjes së shkallës së pazbatueshmërisë së masave organizative të propozuara nga KLSH-ja. Gjatë vitit 2013 rezultoi shifra më e lartë e moszbatimit në 4 vitet e fundit.

- Raporti nuk paraqet të dhëna lidhur me marrjen në konsideratë të propozimeve të rëndësishme për ndryshime, në kuadrin kushtetues dhe ligjor, që KLSH-ja ka adresuar pranë organeve kompetente.

- Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017 përbën një arritje konkrete për veprimtarinë e institucionit, e cila do të ketë impaktin e vet pozitiv si në aspektin e ushtrimit të detyrave funksionale, ashtu edhe në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore.

- Ka rritje të transparencës institucionale të KLSH-së, veçanërisht në komunikimin e drejtpërdrejtë me median, si dhe nëpërmjet publikimeve dhe botimeve zyrtare dhe shkencore.

- Ka intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe me institucionet vendase, të përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike.

- Gjatë vitit 2013 KLSH-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë menaxhimit institucional, duke pasqyruar ecurinë e reformës në zhvillimin e burimeve njerëzore, lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale, të etikës dhe të performancës në tërësi.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2014, kërkon nga KLSH-ja:

1. Angazhim maksimal, në zbatimin e politikave antikorruption, në funksion të detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe kërkesave të organizmave ndërkombëtarë, rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Europian, me qëllim mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë.

2. Ndjekjen rast pas rasti të ecurinë së kallëzimeve penale, duke ridimensionuar komunikimin institucional me organet e drejtësisë dhe me institucionet e hetimit, si dhe kërkimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

3. Hartimin e programeve të punës për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë audituese në drejtim të auditimit të performancës, auditimit financiar dhe atij tematik, si dhe rifillimin e punës për auditimin vlerësues.

4. Garantimin e veprimtarisë audituese me cilësi të lartë dhe efektivitet, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit.

5. Konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerët vendas dhe të huaj, me synim përmirësimin e menaxhimit publik dhe financiar të vendit.

6. Vijimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe institucionet ligjzbatuese për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

7. Rritjen e numrit të auditimeve të subjekteve me projekte me financim të huaj, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e shpërdorimeve të fondeve publike dhe mungesës të efektivitetit të investimeve.

8. Reformimin e burimeve njerëzore për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuar nga INTOSAI për arritjen e objektivave integrale të vendit.

9. Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivelet bashkëkohore, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë.

10. Strukturimin e raportit vjetor, në aspektin formal dhe të përmbajtjes, sipas përcaktimeve kushtetuese, ligjore dhe standardeve të aplikueshme nga institucionet homologe të auditit të jashtëm.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që:

Në ushtrim të funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë mbështet ndërveprimin gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve ligjzbatuese, lidhur me detyrueshmërinë e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 26.6.2014

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006